



Originali: **anglisht**

Nr.: **ICC-02/05-01/09**

Data: 6 mars 2009

DHOMA PARA-GJYQËSORE I

Para: Gjyqtarja Akua, Kryetare e Trupit Gkykues
Gjyqtarja Anita Ušacka
Gjyqtarja Sylvia Steiner

SITUATA NË DARFUR, SUDAN

NË LËNDËN

PROKURORI kundër OMAR HASSAN AHMAD AL BASHIR ("OMAR AL BASHIR")

Dokument Publik

**KËRKESË TË GJITHA SHTETEVE PALË TË STATUTIT TË ROMËS PËR
ARRESTIMIN DHE DORËZIMIN E OMAR AL BASHIR-it**

Burimi: Sekretarja e Gjykatës

Të njoftohen me dokumentin në përputhje me rregulloren 31 të *Rregulloreve të Gjykatës*:

Zyra e Prokurorit Z. Luis Moreno Ocampo, Prokuror Z. Essa Faal, Avokat Senior Gjyqësor	Avokati i Mbrojtjes
Përfaqësuesit Ligjorë të Viktimave	Përfaqësuesit Ligjorë të Paditësve
Viktimat e Papërfaqësuara	Paditësit e Papërfaqësuar për Pjesëmarrje/Zhdëmtim
Zyra e Avokatit Publik për Viktimat	Zyra e Avokatit Publik për Mbrojtjen
Përfaqësuesit e Shteteve	Miqtë e Gjykatës
SEKRETARIA	
Sekretarja e Gjykatës Znj. Silvana Arbia	Seksioni për Mbështetjen e Mbrojtjes
Njësia për Viktima dhe Dëshmitarë	Seksioni i Paraburgimit
Seksioni i Pjesëmarrjes dhe Zhdëmtimit të Viktimave	Të tjerë

SEKRETARJA e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (“Gjykata”);

DUKE MARRË SHËNIM referimin e situatës në Darfur, Sudan, te Prokurori i Gjykatës nga ana e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në rezolutën e tij 1593 të 31 marsit 2005;¹

DUKE MARRË SHËNIM *Vendimin mbi Aplikacionin e Prokurorisë për një Urdhër Arresti kundër Omar Hassan Ahmad Al Bashir-it*, të lëshuar më 4 mars 2009 nga Dhoma Paragjyqësore I (“Vendimi”);²

DUKE MARRË SHËNIM urdhër-arrestin për Omar Al Bashir-in të nxjerrë më 4 mars 2009 nga Dhoma Paragjyqësore I (“Dhoma”) sipas nenit 58 të *Statutit të Romës*;³

DUKE MARRË SHËNIM nenet 19, 20, 57 deri 60, 67, 87, 89, 91 dhe 97 të *Statutit të Romës*, rregullat 21, 117 deri 119, 176, 184, 187 dhe 196 të *Rregullave të Procedurës dhe Evidencës* dhe rregulloret 31 dhe 111 të *Rregulloreve të Gjykatës*;

DUKE MARRË PARASYSH që neni 89(1) i *Statutit të Romës* parashikon që Gjykata mund t’i transmetojë një kërkesë për arrestimin dhe dorëzimin e një individi cilitdo Shtet në territorin e të cilit mund të ndodhet ai individ;

¹ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1593, S/RES/1593 (2005), e miratuar më 31 mars 2005.

² ICC-02/05-01/09-3.

³ ICC-02/05-01/09-1.

DUKE MARRË PARASYSH se Dhoma i kërkoi Sekretarisë të përgatisë dhe t'u transmetojë të gjitha Shteteve Palë të *Statutit të Romës*, në përputhje me rregullën 176(2) të *Rregullave të Procedurës dhe Evidencës*, një kërkesë për arrestimin dhe dorëzimin e Omar Al Bashir-it;

KËRKON që individi në vijim të arrestohet dhe të dorëzohet në përputhje me Vendimin dhe në pajtim me urdhërin e arrestit:

- Emri: Omar Hassan Ahmad Al Bashir ("Omar Al Bashir"), po ashtu i shkruar: Omar al-Bashir, Omer Hassan Ahmed El Bashire, Omar al-Beshir, Omar el-Bashir, Omer Albasheer, Omar Elbashir dhe Omar Hassan Ahmad el-Béshir,
- Datëlindja: 1 janar 1944,
- Nacionaliteti: sudanez,
- Profesionit: President i Republikës së Sudanit,
- Akuzat: Pretendohet të ketë kryer krime të luftës sipas nenit 8 të *Statutit të Romës* dhe krime kundër njerëzimit sipas nenit 7 të *Statutit të Romës*, në regjionin e Darfurit;

Në rast të arrestimit dhe dorëzimit:

KËRKON që siguria e Omar Al Bashir-it të sigurohet deri në dorëzimin e tij final te Sekretarja e Gjykatës;

KËRKON, në pajtim me nenin 87(4) të *Statutit të Romës*, që çfarëdo infomacioni që bëhet i disponueshëm sa i përket kësaj kërkesë të paraqitet dhe trajtohet në një

mënyrë që mbron sigurinë dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike të çfarëdo viktimash, dëshmitarësh potencialë dhe të familjeve të tyre;

KËRKON që Gjykata të njoftohet për çfarëdo aplikacioni të bërë nga Omar Al Bashir pranë ndonjë gjykate nacionale sipas neneve 59(3) ose 89(2) të *Statutit të Romës*;

KËRKON që Gjykata të njoftohet, në pajtim me nenin 91(2)(c) të *Statutit të Romës* për çfarëdo dokumentash, deklaratash apo infomacioni, përpos fletë-arrestit, siç mund të jetë e domosdoshme për të plotësuar kërkesat për procesin e dorëzimit.

KËRKON që Gjykata të njoftohet, në pajtim me nenin 97 të *Statutit të Romës*, për çfarëdo problemi që mund të pengojë apo ndalojë ekzekutimin e kësaj kërkesë;

KËRKON që Gjykata të informohet, në pajtim me nenin 89(4) të *Statutit të Romës*, për çfarëdo problemi që mund të vonojë ekzekutimin e kësaj kërkesë;

KËRKON që Sekretarja e Gjykatës të informohet menjëherë, në pajtim me rregullën 184 të *Rregullave të Procedurës dhe Evidencës*, kur Omar Al Bashir të jetë i disponueshëm për dorëzim;

KËRKON që Omar Al Bashir-i t'i dorëzohet Gjykatës sa më parë që të jetë e mundshme, pasi që të jepet urdhri që ai të dorëzohet;

PËRKUJTON obligimin për t'iu përmbajtur procedurës që jepet në nenin 59 të *Statutit të Romës*;

I BASHKËNGJIT kësaj kërkesë, në përputhje me nenet 87 dhe 91 të *Statutit të Romës*, rregullën 187 të *Rregullave të Procedurës dhe Evidencës* dhe rregulloren 111 të *Rregulloreve të Gjykatës*, këto dokumente:

- i) një kopje të urdhër-arrestit për Omar Al Bashir-in nxjerrë më 4 mars 2009;
- ii) një kopje të dispozitave relevante të *Statutit të Romës* dhe të *Rregullave të Procedurës dhe Evidencës* në një gjuhë të cilën Omar Al Bashir-i plotësisht e kupton dhe e flet.

/nënshkrimi/

Marc Dubuisson,

Drejtor i Seksionit të Shërbimeve të Gjykatës,
në emër të Silvana Arbia, Sekretare e Gjykatës

Sot më datën 6 mars 2009

Në Hagë, Holandë